



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_277_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_399_05_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_399_05_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Bardhyl Bajrami (shifra e konsumatorit DPR – 90050639) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 25.01.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 14.01.2010 lidhur me kontestimin e korrigjimit të bërë nga ana e KEK-ut.

- Me datë 22.04.2008 konsumatori ka parashtruar kërkesë në KEK për lidhje të re.
Provë: Kërkesa e KEK-ut për lidhje të reja e datës 22.04.2008
- Me datë 24.01.2010 konsumatori prapë ka parashtruar në KEK kërkesë për lidhje të re.
Provë: Kërkesa e KEK-ut për lidhje të reja e datës 22.04.2008

- Me datë 02.02.2009, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 4940254.
Provë: Procesi për pranimin dhe instalimin elektrik i KEK-ut nr. 018321 të datës 02.02.2009
- Në periudhën 02/2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me faturë të energjisë elektrike prej 5,937 kWh, apo në vlerë financiare prej **444.96 €**.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 12.03.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar bilancin fillestar dhe ngarkesën me mbi limit.
Provë: Ankesa e konsumatorit e datës 12.03.2009
- Me datë 29.08.2009 KEK-u nëpërmjet Urdhër lejimit / Ngarkimit nr. 22523 ka bërë korrigjimin në vlerë prej 28.62 €, ku në përshkrim theksohet se me vonesë të pranimit të lidhjes së re janë korrigjuar faturat prej 05/2008 – 02/2009.
Provë: Urdhër lejimi / ngarkimi nr. 22523 të datës 29.08.2009
- Me datë 12.01.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kërkuar nga ana e KEK-ut përgjigje të KEK-ut me shkrim dhe me të detajuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK me datë 12.01.2010
- Me datë 14.01.2010 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke theksuar se korrigjimi është bërë në vlerë prej 28.26 €, korrigjimi ka ndodhur për faturat prej 05/2008 – 02/2009 për shkak të vonesës së pranimit të lidhjes së re, sa i përket implementimit të shërbimit të lidhjes së re në vlerë prej 116.00 € nuk është realizuar.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datë 14.01.2010
- Me datë 25.01.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 399_05_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar